



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.103/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Fidanishtja “B....” N.T.SH., me seli në ..., Komuna e Klinës, kundër debitorit “A....” SH.P.K., me seli në, Komuna e Fushë Kosovës, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.29/18, të datë 01.03.2018, të Përbaruesit Privat Hakif L. Hasi, me seli në Gillogoc, jashtë seancës me datë 24.01.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “A....”, SH.P.K. dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr.29/18, i datës 01.03.2018, i Përbaruesit Privat Hakif L. Hasi, për pjesën e detyrimit në shumën prej 8,512.00 € (tetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë euro), sipas Faturës Nr.34/2015 të datës 17.11.2015.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përbarimor P.nr.29/18, të datës 01.03.2018, të Përbaruesit Privat Hakif L. Hasi, sa i përket shumës prej 3,215.00 € (tre mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë euro).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit Fidanishtja “B....” N.T.SH., ndaj debitorit “A....”, SH.P.K., sipas urdhrit P.nr.29/18, të datës 01.03.2018, për shumën prej 8,512.00 € (tetë mijë e pesëqind e dymbëdhjetë euro), sipas Faturës Nr.34/2015 të datës 17.11.2015.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.29/18, të datës 01.03.2018, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës Nr.34/2015 të datës 17.11.2015, duke

urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'ia paguaj kreditorit shumën prej 11,727.00 €, në emër të borxhit kryesor si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat në Kosovë ose përmes regjistrimit, sekuestrimit, vlerësimit dhe shitjes së sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në vlerën e borxhit të kërkuar nga kreditori.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton këtë urdhër për përbarim për shkak të parashkrimit të borxhit për vitet 2012,2013,2014 dhe 2015, duke u bazuar në nenin 357 par.1 të LMD-së , sipas të cilit parashihet se kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhen për tri vite nga dita kur i dëmtuari ka marrë në dijeni për dëmin dhe për personin i cili ka shkaktuar dëm. Ka shtuar se urdhri për përbarim është lëshuar me datë 01.03.2018, ndërsa borxhi i kërkuar nga kreditori është përmbledhje e faturave për vitet 2012, 2013, 2014, 2015, që do të thotë se propozimi për përbarim është paraqitur pas kalimit të afatit prej 3 viteve. Gjykatës i ka propozuar që të aprovet prapësimi i debitorit dhe të abroget urdhri për lejimin e përbarimit .

Kreditori, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara, duke theksuar se debitori nuk ka nuk ka bashkëngjitur prova për ti mbështetur pretendimet e tij në kuptim të nenit 69 par 4 të LPP –së. Ka theksuar se pretendimi i debitorit në lidhje me parashkrimin e borxhit nuk qëndron për shkak se objekt i përbarimit është fatura nr.34/2014 e datës 17.11.2015, jo faturat për shërbimet e kryera gjatë viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Për më tepër dokumenti i besueshëm përkatësisht fatura ka afatin e pagesës dhe të njëjtën debitori nuk e ka kundërshtuar brenda këtij afati. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pabazuar dhe të vërtetohet urdhri përbarimor P.nr.29/2018 i datës 01.03.2018.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përbaruesit Privat Afet Mjeku, P.nr.29/2018 të datës 01.03.2018, sipas Faturës nr.34/2015 të datës 17.11.2015, është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit. Gjykata erdhi në këtë përfundim, pasi që me bilancin-përmbledhje e faturave për vitin 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017, bashkëngjitur si provë në shkresat e lëndës, konstatoi se debitori e ka përmbushur pjesërisht detyrimin sipas Faturës nr.34/2015 të datës 17.11.2015, për shumën në lartësi prej 8,512.00 €.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 71 par.1 nën par.1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përbarues ose urdhri përbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”* aprovoi pjesërisht prapësimin dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, pasi që dokumenti i besueshëm – fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përbarimor, e ka humbur pjesërisht efektin, sepse e njëjta është përmbushur pjesërisht nga ana e debitorit.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi urdhrin e përbaruesit privat P.nr.29/2018 të datës 01.03.2018, për pjesën tjetër të detyrimit, përkatësisht për shumën në vlerë prej 3,215.00 €, për faktin se dokumenti i besueshëm – fatura në bazë të cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara, si dhe është e përshtatshme për përbarim, bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “.* Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht Faturës nr.34/2015 të datës 17.11.2015, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në të janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përcaktuara mallrat të cilat kanë qenë objekt i kësaj fature, koha e përmbushjes së detyrimit, si dhe shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, e po ashtu e njëjta është pranuar nga debitori, gjë e cila e cila vërtetohet edhe nga nënshkrimi i debitorit.

Gjykata po ashtu gjen se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë as me parashkrim të kërkesës, pasi që bazuar në dispozitën e nenit 355 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me të cilën përcaktohet se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite”*, rezulton se propozimi për përmbarim është paraqitur brenda afatit 3 (tre) vjeçar të përcaktuar si më lartë, pasi që Urdhri Përmbarimor P.nr.29/2018 është lëshuar me datën 01.03.2018, ndërsa Fatura nr.34/2015 është lëshuar me datë 17.11.2015.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar pjesërisht detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbarimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit si rrjedhojë e përmbushjes së pjesërishtme të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përmbarimor e lë në fuqi, sa i përket pjesës së mbetur prej 3,215.00 €.

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 64 par.4, nenin 71 dhe nenin 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.103/22, datë 24.01.2023

Gjyqtarja

Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.